# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-477545**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Edhe Greqia ndjek modelin italian, qendër riatdhesimi për emigrantët në një vend afrikan! |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/rajoni/edhe-greqia-ndjek-modelin-italian-qender-riatdhesimi-per-emigrantet-ne-nj-i589049` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 19:44:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 19:40:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | c2014e48cdec3b3c275c383fd51f7501965332a9316c4149f4625859c66e449f |
| TEKSTI | 04186891431e151fe3fabb7be325c873c49c85ea72e6edbc2a190468f9bcdd88 |
| PAMJA | 26b78fc42f0c87c8dc24d1f69103e8b10aa641e285c451f14743188d73e01288 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 4c349267177c3e33326900e1e5b3506a245028d0741938057e583a87325f900b |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 6a4afcda2fdbaa1fd2c3f5e26c1cb3946785567999c2c435268418bbbef9bbb6 |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4c349267177c3e33326900e1e5b3506a245028d0741938057e583a87325f900b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Edhe Greqia ndjek modelin italian, qendër riatdhesimi për emigrantët në një vend afrikan!

TemA

28 Shtator 2026, 21:40Rajoni TEMA



Greqia po përgatitet të ndjekë hapat e Italisë, duke planifikuar ngritjen e një qendre riatdhesimi për emigrantët në një shtet afrikan.

Lajmi u bë i ditur nga ministri grek për Migracionin dhe Azilin, Thanos Plevris, gjatë një interviste për televizionin Ant1, ku specifikoi se qendra pritet të jetë funksionale gjatë presidencës së radhës së BE-së në gjysmën e dytë të vitit 2027.

Edhe pse vendndodhja e saktë nuk është bërë ende publike, duke u lënë të kuptohet se është identifikuar tashmë – me shtete si Uganda dhe Ruanda si opsione të mundshme – projekti po zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Danimarkën, Austrinë, Gjermaninë dhe Holandën.

Në prag të Këshillit Evropian të Çështjeve të Brendshme më 1 tetor, ministri Plevris paralajmëroi se Greqia do të paraqesë një propozim për "një mekanizëm për masa të jashtëzakonshme". Ky hap vjen si reagim ndaj situatave të ngjashme me flukset masive në enklavën spanjolle të Ceutës, ku u raportua kalimi i 72,000 migrantëve nga Maroku.

"Në kohë krize, duhet të merren masa jokonvencionale," deklaroi Plevris, duke shtuar se në raste të tilla të shfrytëzimit të migracionit, kërkesat për azil nuk duhet të merren në konsideratë, por të shoqërohen me urdhra dhe zbatim të menjëhershëm të riatdhesimit.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Athina mohon kërcënimin e ambasadores amerikane për rrëzimin e qeverisë greke]

21:30 Rajoni

Prishtinë/ 'Jo në emrin tim', vijon për të 13-ën natë protesta kundërvendimit dënues të Gjykatës Speciale

21:20 Rajoni

[Pas bisedës Vuçiç-Putin, Departamenti i Shtetit rikujton deklaratën e Rubios: Serbia, e përfshirë në çështje problematike]

20:40 Rajoni

[Partitë në Kosovë ende pa marrëveshje për presidentin e ri, ndërsa afati po shkon drejt fundit]

18:30 Rajoni / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.